Në mbështetje të nenit 17, nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafit 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 gusht 2024, merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet propozimi për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministres së Drejtësisë për nënshkrimin e Marrëveshjes për Ekstradim ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Francës.

2. Rekomandohet Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij vendimi në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 14/216**
**Datë: 14.08.2024**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 30 paragrafit 3. të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, të nenit 15 paragrafit 1. të Ligjit Nr.08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 gusht 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për transfer të mjeteve buxhetore në shumë prej 800,000€ (tetëqind mijë euro), deri nën 25% të ndarjes së ndikuar negativisht për vitin 2024, lidhur me përmbushjen e obligimeve që dalin nga marrëveshja me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM), për projektet "Kthimi dhe Riintegrimi Faza e VI" dhe "Projekti i BE-së për Stabilizim të Komuniteteve V", në kuadër të IPA 2022.

2. Mjetet buxhetore sipas pikës 1. të këtij vendimi merren nga Ministria për Komunitete dhe Kthim me kod 211, nga nën-programi "Projekti i Konsoliduar për të Kthyerit", me kod 46200, nga kategoria e shpenzimeve "Investime Kapitale" nga projekti "Projekti RRK –IV-" me kod 11053 dhe transferohen në nën-programin "Administrata Qendrore" me kod 11311, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".

3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim, për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 15/216**
**Datë: 14.08.2024**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 14, paragrafit 3. të Ligjit Nr.08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 gusht 2024, merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet rialokimi i mjeteve në shumë prej: 50,000.00€ (pesëdhjetë mijë euro), në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal me kod 212, nën-programi Administrata Qendrore me kod 11312, nga kategoria e shpenzimeve kapitale konkretisht nga projekti kapital "Programi Komunal për Zhvillim të Infrastrukturës Socio-ekonomike dhe Bashkëpunim Ndër-komunal", me kod 15633 në projektin kapital në përputhje me marrëveshjen e mirëkuptimit të nënshkruar nga Ministri i MAPL-së dhe Kryetari i Komunës së Obiliqit.

2. Mjete nga pika 1. e këtij vendimi rialokohen nga projekti kapital "Programi Komunal për Zhvillim të Infrastrukturës Socio-ekonomike dhe Bashkëpunim Ndër-komunal", me kod 15633 në projektin e ri kapital Asfaltimi Rrugëve "Pushka e Parë dhe Ali Gollaku" Komuna e Obiliqit në vlerë prej 50,000.00€.

3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 16/216
Datë: 14.08.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 12 të Ligjit Nr.08/L-137 për Pyjet, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 gusht 2024, merr këtë:

# V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronat e kërkuara nga Komuna e Dragashit të menaxhuara nga Agjencia Pyjore e Kosovës për dhënien në shfrytëzim të parcelës P-706040014-00772-0, me sipërfaqe 2072m2/ZK Dragash në vendin e quajtur DRAGASh-LUBOJCA PIJAC, pjesë e parcelës që do të shfrytëzohet është 600 m2.

2. Përfituesi i së drejtës së shfrytëzimit afatgjatë, të ngastrës P-706040014-00772-0 me sipërfaqe 2072m2, ZK Dragash në vendin e quajtur DRAGASh-LUBOJCA PIJAC, është Komuna e Dragashit dhe shërben për rindërtimin e Muzeut ekzistues dhe ndërtimin e Bibliotekës dhe Ateljes. Pjesa e parcelës që do të shfrytëzohet është 600 m2.

3. E drejta e shfrytëzimit sipas pikës 1. të këtij vendimi bëhet për rindërtimin e Muzeut ekzistues dhe ndërtimin e Bibliotekës dhe Ateljes.

4. Ngastrat me të dhënat e paraqitura konform kërkesës së Komunës së Dragashit, regjistrohen si shfrytëzues në emër të Komunës së Dragashit.

5. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përkatësisht Agjencia për Menaxhimin e Pyjeve të Kosovës dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 17/216**
**Datë: 14.08.2024**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 49 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 16 të Rregullores Nr.15/ 2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 gusht 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Z. Jeton Qela, emërohet Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë katër (4) vjet.

3. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

4. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 18/216**
**Datë: 14.08.2024**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 80 të Ligjit Nr. 06/L- 026 për Azil, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 gusht 2024, merr këtë:

## V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 2. e Vendimit të Qeverisë Nr. 10/68 të datës 23 mars 2022 si në vijim:

   - Personat, subjekt i mbrojtjes së përkohshme nga pika 1. e këtij vendimi janë njëzetë e një (21) gazetarë Ukrainas, përfshirë anëtarët e ngushtë të familjes së tyre.

2. Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Qeverisë Nr. 10/68 të datës 23 mars 2022.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

## Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 19/216**
**Datë: 14.08.2024**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 30, paragrafit 3. të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 15 paragrafit 1. të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 gusht 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë të Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për transfer të mjeteve buxhetore në shumë prej 1,999,000€ (një milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë euro), deri nën 25% të ndarjes së ndikuar negativisht për vitin 2024, për përkrahjen e ndërmarrjeve përfituese të skemës së granteve "Përkrahja e Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme për Blerjen e Makinerive Prodhuese dhe Përpunuese".

2. Mjetet buxhetore sipas pikës 1. të këtij vendimi merren nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me kod 204, nga nën-programi "Agjencioni për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë", me kod 49000 nga kategoria e shpenzimeve "Investime Kapitale", nga projekti "Ndërtimi i Zonave Ekonomike nëpër Kosovë" me kod 12664 dhe transferohen në nën-programin e njëjtë, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".

3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 20/216**
**Datë: 14.08.2024**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafit 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 gusht 2024, merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Komunës së Prizrenit për projektin "Efiçienca e Energjisë në ndërtesa Publike në Prizren" nga Programi Rajonal i Efiçiencës së Energjisë për Ballkanin Perëndimor (REEP2).

2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeminister i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 21/216**
**Datë: 14.08.2024**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, paragrafi 2, neni 12 të Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 gusht 2024, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 15/158 të datës 29 nëntor 2013**

1. Ndryshohet dhe plotësohet Aneksi 1. i përcaktuar në pikën 1. të Vendimit të Qeverisë Nr. 15/158, të datës 29 nëntor 2013, për shtetet: Republika e Botsvanës, Republika e Namibisë dhe Republika e Afrikës së Jugut, ndaj të cilave vendoset regjimi i vizave.

2. Ndryshohet dhe plotësohet pika 8. e Vendimit Nr. 15/158, të datës 29 nëntor 2013 si në vijim: Bartësit e dokumenteve të udhëtimit të lëshuara nga Tajvani, lirohen nga kushti për të njoftuar paraprakisht Misionet Diplomatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës.

3. Obligohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës, për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit të Qeverisë Nr. 15/158 të datës 29 nëntor 2013.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 22/216**
**Datë: 14.08.2024**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 30 paragrafit 3. të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 15 paragrafit 1. të Ligjit Nr.08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 gusht 2024, merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për ndarjen e mjeteve buxhetore në shumë prej 7,375,138€ (shtatë milionë e treqind e shtatëdhjetë e pesëmijë e njëqind e tridhjetë e tetë euro), deri nën 25% të ndarjes së ndikuar negativisht për vitin 2024, për subvencionimin e blerjes së teksteve dhe materialeve mësimore për vitin shkollor 2024/2025.

2. Mjetet buxhetore sipas pikës 1. të këtij vendimi merren nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, me kod 208, nga nën-programet dhe kategoritë e shpenzimeve, si në vijim:

   2.1. Trajnimi i Mësuesve me kod 91000, merret shuma prej 97,397.70€ (nëntëdhjetë e shtatëmijë e treqindenëntëdhjetë e shtatë euro e shtatëdhjetë cent) nga kategoria e shpenzimeve "mallra dhe shërbime", shuma e ndikuar negativisht është -24.99%.
   2.2. Zhvillimi i Plan programit me kod 91100, merret shuma prej 49,980€ (dyzetë e nëntëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë euro) nga kategoria e shpenzimeve "mallra dhe shërbime", shuma e ndikuar negativisht është -24.99%.
   2.3. Arsimi Profesional me kod 92500, merret shuma prej 27,524.40€ (njëzetë e shatë mijë e pesëqind e njëzetë e katër euro e katër dhjetë cent) nga kategoria e shpenzimeve "mallra dhe shërbime", shuma e ndikuar negativisht është -24.99%.
   2.4. Administrata Qendrore me kod 11308, merret shuma prej 441,458.80 € (katërqind e dyzetë e një mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë euro e tetëdhjetë cent) nga kategoria e shpenzimeve "mallra dhe shërbime", shuma e ndikuar negativisht është -24.99%.
   2.5. Inspektorati i Arsimit të Kosovës me kod 98000, merret shuma prej 85,115.90 € (tetëdhjetë e pesëmijë e njëqind e pesëmbëdhjetë euro e nëntëdhjetë cent) nga kategoria e shpenzimeve "mallra dhe shërbime", shuma e ndikuar negativisht është -24.99%.
   2.6. Investimet kapitale në Arsimin para-universitar me kod 98100, merret shuma prej 1,521,000€ (një milion e pesëqind e njëzetë e njëmijë euro) nga kategoria e shpenzimeve "mallra dhe shërbime", shuma e ndikuar negativisht është -24.99%.

2.7. Zyra e Ministrit me kod 11408, merret shuma prej 34,472.70€ (tridhjetekatërmijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy euro e shtatëdhjetë cent) nga kategoria e shpenzimeve "mallra dhe shërbime" shuma e ndikuar negativisht është -24.99%.

2.8. Trajnimi i Mësuesve me kod 91000, merret shuma prej 999.00€ (nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë euro) nga kategoria e shpenzimeve "shpenzime komunale", shuma e ndikuar negativisht është -24.99%.

2.9. Administrata Qendrore me kod 11308, merret shuma prej 8,440.50€ (tetëmijë e katërqind e dyzetë euro e pesëdhjetë cent) nga kategoria e shpenzimeve "shpenzime komunale", shuma e ndikuar negativisht është -24.99%.

2.10. Zyra e Ministrit me kod 11408, merret shuma prej 999.00€ (nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë euro) nga kategoria e shpenzimeve "shpenzime komunale" shuma e ndikuar negativisht është -24.99%.

2.11. Inspektorati i Arsimit të Kosovës me kod 98000, merret shuma prej 3,324.00€ (tremijë e treqind e njëzetë e katër euro ) nga kategoria e shpenzimeve "shpenzime komunale" shuma e ndikuar negativisht është -24.99%.

2.12. Arsimi Profesional me kod 92500, merret shuma prej 37,477€ (tridhjetë e shtatë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë euro) nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", shuma e ndikuar negativisht është -24.99%.

2.13. Përkrahja e nxënësve me potencial të jashtëzakonshëm me kod 98300, merret shuma prej 49,950.00€ (dyzetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë euro) nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", shuma e ndikuar negativisht është - 24.99%.

2.14. Administrata Qendrore me kod 11308, merret shuma prej 1,516,999.00€ (një milion e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë euro) nga kategoria e shpenzimeve "subvencione dhe transfere", shuma e ndikuar negativisht është -24.99%.

2.15. Investimet kapitale në Arsimin Para-universitar me kod 98100, merret shuma prej 3,500,000€ (tre milionë e pesëqind mijë euro) nga kategoria e shpenzimeve "shpenzime kapitale", shuma e ndikuar negativisht është -24.45 %, mjetet merren nga këto projekte:

2.15.1. Ndërtimi i çerdheve modulare në 7 regjionet e Kosovës, Prishtinë, Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj, Pejë, Prizren dhe Gjakovë, me kod 19272, shuma prej 1,200,000€;

2.15.2. Ndërtimi i çerdheve për fëmijë, me kodi 19008, shuma prej 300,000.00€;

2.15.3. Participim në projektin IPA 2023 në ndërtim të çerdheve, me kod 19117, shuma prej 1,000,000€; dhe

2.15.4. Dixhitalizim, pajisje me kompjuter, tabela smart e projektor, me kod 19128, shuma prej 1,000,000€.

3. Mjetet buxhetore sipas pikës 2. të këtij vendimi, transferohen në nën programin Investimet kapitale në Arsimin para-universitar me kod 98100, në kategorinë e shpenzimeve "subvencione dhe transfere".

4. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 23/216**
**Datë: 14.08.2024**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 23 Ligjit Nr.08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, Vendimin Nr. 15/62 të datës 23.02.2022, Vendimin Nr. 04/90 të datës 26.07.2022, Vendimin Nr. 20/140 të datës 26.04.2023, dhe Vendimin Nr. 23/159 të datës 13.09.2023, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 gusht 2024, merr këtë:

# V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 12,328,684€ (dymbëdhjetë milionë e treqind e njëzetë e tetë mijë gjashtëqind e tetëdhjetë e katër euro) për zbatimin e Masës 4.1- "Mbështetja për Shëndetësinë", Masës 4.2 - "Mbështetja e Arsimit" dhe Masës 4.6 - "Mbështetja e Ndërmarrjeve Publike" të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.

2. Mjetet buxhetore sipas pikës 1. të këtij vendimi merren nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, me kod 201, nga nën-programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe ndahen si në vijim:

    2.1. Në Ministrinë e Shëndetësisë me kod 206, në shumë prej 1,770,560€ (një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë euro), në nën-programin "Programet Tjera" me kod 72100, në kategorinë e shpenzimeve "Investime Kapitale" në projektin "Pajisje speciale shëndetësore mbi 1000 euro" me kod 19108, për zbatimin e Masës 4.1-Mbështetja e Shëndetësisë;

    2.2. Në Ministrinë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, me kod 208, në shumë prej 6,543,532€ (gjashtë milionë e pesëqind e dyzetë e tre mijë e pesëqind e tridhjetë e dy euro), në nën-programin "Investimet kapitale në Arsimin Para-universitar" me kod 98100, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", për zbatimin e Masës 4.2 -Mbështetja e arsimit, për subvencionimin e teksteve dhe mjeteve shkollore;

    2.3. Në Ministrinë e Ekonomisë me kod 213, shuma prej 4,014,592€ (katër milionë e katërmbëdhjetë mijë e pesëqind nëntëdhjetë e dy euro), në nën-programin "Minierat e Trepçës" me kod 22800, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", për zbatimin e Masës 4.6 - Mbështetja e Ndërmarrjeve Publike.

3. Mjetet buxhetore sipas këtij vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e projektit (00098) te organizata buxhetore dhe programi përkatës.

4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 24/216**
**Datë: 14.08.2024**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 19, paragrafit 2. dhe nenit 43 paragrafit 1. të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 11 dhe 22 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjit Nr. 05/L-009, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 gusht 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Shkarkohet Bordi i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Hidrodrini" Sh. A Pejë.

2. Emërohet Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Hidrodrini" Sh. A Pejë në këtë përbërje:

    2.1. Qëndresa Kukaj, kryesuese;
    2.2. Mirjeta Heta, anëtare;
    2.3. Samir Lleshi, anëtar;
    2.4. Noli Carrabregu, anëtar.

3. Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve ushtron kompetencat e Bordit të Drejtorëve në përputhje me Ligjin Nr. 030-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe i plotësuar Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009.

4. Mandati i Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve zgjatë deri në emërimin e Bordit të Drejtorëve, por jo më shumë se gjashtë (6) muaj.

5. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 11/118 i datës 11 janar 2023.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
***Qeveria – Vlada – Government***
***Ministria e Ekonomisë – Ministarstvo Ekonomije – Ministry of Economy***

**REKOMANDIM**

Për shkarkimin e Bordit të Drejtorëve dhe emërimin e Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Hidrodrini" ShA Pejë

Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidrodrini" ShA Pejë është ndërmarrje publike qendrore në pronësi të plotë të Republikës së Kosovës. Qeveria ushtron detyrat e aksionarit në përputhje me Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjet nr. 04/L-111, 05/L-009 dhe 06/L-021. Njësia për Politikat dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike (NjPMNP), në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, mbështet Qeverinë në ushtrimin e detyrave të aksionarit.

Mbështetur në nenin 19 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, aksionari shkarkon dhe zëvendëson anëtarin e Bordit të Drejtorëve për shkeljen e detyrave fiduciare. Shkarkimi mund të bëhet sipas paragrafit 2 të atij neni, me rekomandim nga NjPMNP, e cila konstaton se shkelja ka ndodhur. Shkarkimi mund të bëhet edhe sipas paragrafit 3, kur aksionari "ka arsye për të besuar" se anëtari i Bordit të Drejtorëve ka shkelur detyrat fiduciare.

Termi *detyrë fiduciare*, i huazuar nga anglishtja, përkufizohet si detyrë për të vepruar me ndershmërinë dhe besnikërinë më të lartë ndaj ndërmarrjes dhe aksionarit dhe në interesin e tyre më të mirë.

Bordi i Drejtorëve të KRU Hidrodrinit është emëruar me Vendimin nr. 11/118 të datës 11.01.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Në kuadër të kompetencave të veta, pasi ka analizuar vendimet dhe procesverbalin e mbledhjes së Bordit të Drejtorëve dhe i ka krahasuar ato me raportet periodike dhe shkresat e tjera të ndërmarrjes, NjPMNP ka identifikuar veprime që përbëjnë shkelje të detyrave fiduciare. Prandaj, me shkresën e datës 14.08.2024, ka konstatuar se anëtarët e Bordit të Drejtorëve të KRU Hidrodrinit kanë shkelur detyrat fiduciare dhe ka rekomanduar shkarkimin e tyre dhe emërimin e një bordi të përkohshëm të drejtorëve sipas ligjit.

Me Vendimin nr.prot. 42-5 të datës 31.07.2024, Bordi i Drejtorëve ka shkarkuar Kryeshefin Ekzekutiv, z. Dri Cena, i cili ka marrë detyrën më 01.06.2023. Arsyetimi i vendimit përmban përshkrime të përgjithësuara dhe kundërthënëse si dhe konstatime të gabuara dhe të jo të plota, ku ndër të tjera:

1. Thuhet se vlerësimi i performancës së Kryeshefit Ekzekutiv për periudhën 01.06.2023–30.11.2023 ka qenë negativ, ndërsa Vlerësimi i performancës së menaxhmentit për vitin 2023, i miratuar nga Bordi i Drejtorëve me Vendimin nr. 4/2024 të datës 30.04.2024, cek se "në

përgjithësi, suksesi i angazhimeve dhe rezultatet e Kryeshefit Ekzekutiv [...] për vitin 2023 vlerësohen të kënaqshme" (f. 4).

2. Konstatohet se Kryeshefi Ekzekutiv ka dështuar të reduktojë humbjet e ujit gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024, përkundër faktit se të dhënat nuk janë të krahasueshme meqë ka pasur pasaktësi në raportimin e humbjeve të ujit gjatë periudhës paraprake. Ndërmarrja ka siguruar instalimin e 29 ujëmatësve në pikat e prodhimit në tetor 2023, dhe raportimi i saktë i humbjeve të ujit ka filluar tek pasi është miratuar plani i biznesit.

3. Konstatohet se Kryeshefi Ekzekutiv ka dështuar të zvogëlojë llogaritë e arkëtueshme dhe të rritë të hyrat, përkundër faktit se gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024 të hyrat janë rritur për 24 për qind, arkëtimi është rritur për 12,7 pikë përqindje dhe bilanci negativ prej -204 mijë euro është kthyer në bilanc pozitiv prej +19 mijë euro, krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2023. Të hyrat dhe bilanci janë përmirësuar edhe pse janë shtuar shpenzimet pasi ndërmarrja ka zgjeruar shërbimet në komunat ku operon, ka marrë në menaxhim rrjetin e kanalizimit prej rreth 300 kilometrash, ka shtuar numrin e punëtorëve të terrenit, si dhe ka rritur pagat për të siguruar kompensim të denjë për stafin, ndërsa këto shpenzime nuk janë reflektuar në tarifa.

Ndonëse emërimi dhe shkarkimi i Kryeshefit Ekzekutiv është kompetencë e Bordit të Drejtorëve, ushtrimi i kësaj kompetence duhet të jetë në përputhje me detyrat fiduciare. Për arsyet e sipërcekura, vendimi për shkarkimin e Kryeshefit Ekzekutiv vë në pikëpyetje besueshmërinë e vendimmarrjes së anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, andaj i rekomandohet Qeverisë shkarkimi i tyre dhe emërimi i Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve në përputhje me nenin 19 dhe nenin 43 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike.